



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## **KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT PRANON PJESËRISHT PROVAT E PARAQITURA NË SEANCË GJYQËSORE NGA GJYQTARI I TIRANËS DHE ISH KANDIDATI PËR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR, Z. ASTRIT FAQOLLI**

Z. Astrit Faqolli, Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ish kandidat për anëtar në KLGJ është konfirmuar nga Komisioni i shkallës së parë të vettingut (KPK) me vendimin e datës 27/05/2018. Ky vendim është ankimuar nga Komisioneri Publik. Kolegji i Posaçëm i Apelit zhvilloi në datën 7 mars 2019, seancën e parë gjyqësore publike për këtë çështje. Kjo seancë u zhvillua përkatësisht 6 muaj pas hedhjes së shortit për caktimin e trupit gjykues.

Vëzhguesit e KShH-së monitoruan seancën e sotshme dëgjimore të zhvilluar në KPA. Subjekti i rivlerësimit dhe mbrojtësi i tij ligjor u pyetën nga kryetarja e trupit gjykues nëse dispononin prova apo akte në lidhje me paqartësinë që ekziston për disbursimin e barnave nga mbyllja e farmacisë së bashkëshortes së tij I.F në vitin 2003 dhe se dyti për dokumentacionin dhe kontratën e shitjes për automjetin Benz.

Mbrojtësi ligjor u shpreh se kishte qënë e pamundur për të disponuar dokumentacionin e asaj kohe mbi disbursimin e barnave dhe mbylljen e farmacisë së bashkëshortes së gjyqtarit. I vetmi akt që kishin arritur të sillnin ishte një deklaratë noteriale e vitit 2012 e lëshuar nga Depo farmaceutike “Elba Farmakrem” ku cilësohej se me mbylljen e farmacisë se bashkëshortës se subjektit, i gjithë malli kundrejtë cmimit ishte blerë nga kjo depo farmaceutike. Në lidhje me paqartësinë për shitjen e automjetit Benz, mbrojtësi ligjor u shpreh se kishin arritur të siguronin përgjigje nga ILDKPKI ku nuk rezulton i administruar ky automjet. Drejtoria Rajonale e Transportit, Tiranë kishte konfirmuar se ky mjet ndodhet në pronësi të shtetasit F.C dhe dosja ndodhet në Drejtorinë Rajonale e Transportit, Elbasan. Në lidhje me këtë fakt avokati mbrojtës kërkoi kohë për t’iu drejtuar kësaj drejtorie për të disponuar dosjen duke e cilësuar si të vetmen mënyrë për të disponuar kontratën e shitjes së tij. Kjo u cilësua nga Komisioneri Publik si zvarritje e procesit të rivlerësimit dhe se ato kishin pasur kohë të mjaftueshme për të siguruar provat dhe aktet në lidhje me këtë çështje.

Përfaqësuesja e ONM, ngriti disa pyetje kundrejtë subjektit të rivlerësimit. Pyetjes së saj mbi pamundësinë e gjetjes se dokumentacionit mbi shitjen e barnave dhe në cilën formë i ishte drejtuar kësaj depo farmaceutike për këto informacione, subjekti konfirmoi se kërkesat nga ana e tij janë bërë në mënyrë verbale dhe në pamundësi të gjetjes së dokumentacionit kanë nënshkruar një deklaratë noteriale mbi këtë fakt. Deklarata noteriale u cilësua si e pavlerë dhe u kërkua nga Komisioneri publik që mos të merrej në cilësinë e provës në bazë të nenit 49 pika 6 e ligji 84/2016 dhe se aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit nuk duhet të merren në konsideratë pasi si në formë edhe në përmbajtje nuk rezultojnë të rregullta.

Në fund të seancës dëgjimore trupi gjykues vendosi të marrë në konsideratë aktet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit në përjashtim të atyre që nuk respektojnë kushtet ligjore për tu paraqitur si provë. Trupi gjykues vendosi të mbyll shqyrtimin gjyqësor të çështjes dhe shtyu seancën dëgjimore në datën 21.03.2019 ora 09.30 për ti dhënë kohë subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtësit të tij ligjor për të sjellë konkluzionet përfundimtare.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Në lidhje me procesin e rregullt ligjor, u respektua akses i publikut në seancë, e drejta e subjektit për tu mbrojtur, e drejta për tu informuar dhe për tu dëgjuar, në zbatim të neneve 23, 42 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , neni 6 KEDNJ, neni 46, 50, 55, 65, Ligji 84/2016, neni 35, 38, 45, 47 të Kodit të Procedurave Administrative.